

## FJALË PËRSHËNDETËSE

*Mario I. Blejër\**

Ashtu siç e përmendi edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe shoku im i mirë, Ardian Fullani, kam kënaqësinë të kthehem këtu pas 14 vjetësh, pasi kam qenë shefi i misionit të parë të FMN-së në Shqipëri. Dhe në fakt, ne jemi këtu, në të njëjtin vend ku filluam, në hotelin “Adriatik” në Durrës. Ne erdhëm në Shqipëri për të punuar mbi zbatimin e kërkesës së këtij vendi për t’u pranuar si anëtar i Fondit, në shkurt të vitit 1991 dhe zgjodhëm për të zhvilluar diskutimet këtë hotel dhe jo Tiranën. U takuam në një nga sallonet e hotelit me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfshirë këtu edhe bankën qendrore, dhe ishte shumë e qartë që ky nuk ishte një propozim praktik. Ditën tjetër udhëtuam për në Tiranë dhe u vendosëm në një nga rezidencat zyrtare që ishte përdorur nga anëtarë të lartë të qeverisë së mëparshme. Kështu, ishim gati të mësonim rreth Shqipërisë dhe ekonomisë së saj.

Në mënyrë që të kuptojmë situatën, është e rëndësishme që si fillim të bëjmë një përmbledhje të vendit dhe kohës. Në fillim të vitit 1991 Muri i Berlinit ra, Bashkimi Sovjetik ishte shpërbërë, dhe në shumë prej vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore ndryshuan regjimet. Disa prej këtyre vendeve ishin pranuar si anëtare të organizatave ndërkombëtare financiare dhe stafi i FMN-së ishte shumë i emocionuar nga detyrat e reja, të krijuara nga procesi i tranzicionit. Dukej sikur zgjerimi i Fondit kishte përfunduar (sigurisht, kjo ishte

përpara ndarjes së ish-Jugosllavisë) dhe sfida ishte të ndiqej stabilizimi dhe reformat. Këto ishin rrethanat kur një shënim shumë misterioz – dhe jo shumë formal – mbërriti në Departamentin Evropian të Fondit. Ky shënim ishte një kërkesë për pranimin e Shqipërisë në organizatë por nuk jepte shumë informacion.

Duke u nisur nga ky shënim dhe më pas, shumë kanale të ndryshme u eksploruan, u ngrit një skuadër dhe ne ishim gati të vinim këtu dhe të fillonim diskutimet mbi çështjet e rëndësishme për pranimin dhe të gjenim informacionin e nevojshëm për të kryer këtë proces. Por, shumë pak dihej për këtë vend dhe kishim shumë pak burime informacioni. Në shënimet tona origjinale ne shkruam: “Deri në fillim të vitit 1991, Shqipëria ka qenë një nga vendet më pak të njohura dhe të arritshme në botë. Ajo e izoloi veten dhe u qeveris nga një regjim autoritar i cili zbatoi ideologjinë strikte marksiste dhe praktikat staliniste. Nuk dihet shumë rreth ekonomisë së vendit por pamja që del përpara është ajo e një ekonomie në mes të një krize serioze dhe të thellë, e cila është ndoshta shumë më e thellë se sa ajo e përjetuar prej vendeve të tjera ish-socialiste. Është duke pësuar një tkurrje në aktivitetin ekonomik, një dëmtim të mprehtë në llogaritë e saj të jashtme, një lodhje virtuale të rezervave në valutë dhe një ngritje të shpejtë të borxhit të jashtëm”.

Dhe me të vërtetë, pasi mblodhëm informacion, mundëm të dokumentonim që rënia e prodhimit ishte rreth 30-40 për qind gjatë vitit 1990 – ‘91 dhe nuk mundëm të gjenim më tepër se 5 milionë dollarë në rezerva të huaja. Megjithë historitë e shumta që mund të tregohen rreth procesit të anëtarësimit dhe rreth tre udhëtimeve tona në Shqipëri atë vit, rezultati final ishte pranimi i Shqipërisë në FMN, në tetor të vitit 1991. Më pak se 14 vjet më vonë, në mars të vitit 2005, raporti i FMN\_së për Shqipërinë, i sapobotuar, na tregon që ekonomia e saj ka patur një rritje më tepër se 6 për qind në vit për dy vitet e fundit, ka një deficit të llogarisë korente prej 7 për qind, të krahasuar me më tepër se 20 për qind që e gjetëm ne, borxhi i jashtëm është 20 për qind më i ulët se PBB, 4 herë më i ulët se sa në fillim të viteve ‘90, dhe rezervat në valutë janë 1 bilion dollarë.

Pa dyshim që ka qenë një rrugë e gjatë dhe megjithëse rruga përpara jush është gjithashtu, e gjatë dhe ekziston një distancë e largët për t’u

arrirë, na ndihmon të hedhim një vështrim dhe të vlerësojmë saktë përpjekjet dhe progresin e bërë, dhe gjithashtu na ndihmon për të përcaktuar rëndësinë e punës që ju pret.

Që nga dita e parë që kemi mbërritur në këtë hotel deri në përfundim të procesit të anëtarësimit, na është dashur të përpiqemi të kuptojmë dhe të përpunojmë informacion, të gjitha llojet e informacioneve - jo vetëm të dhëna dhe fakte ekonomike – i cili na ndihmon për njehsimin e saktë të natyrës së problemeve të këtij vendi, të cilat ishin pothuajse të pangjashme me ato që kemi patur përpara. Kur i kthehem edhe një herë kësaj eksperience, mund të them që në atë kohë, arrita në tre përfundime, prej të cilave nxora disa orientime, që kanë ndërlikime më të gjera. Këto përfundime ishin:

- (a) Ekonomia e vendit ishte shumë e pazakontë, por në një drejtim specifik: vendi kishte zbatuar me ekstremitet politikat, të cilat në vende të tjera ishin të pranishme në një mënyrë të moderuar.
- (b) Njerëzit ishin shumë të mirë dhe bashkëpunues – dhe gjithashtu kishin shumë dëshirë për të mësuar dhe për t'u integruar.
- (c) Vendi kishte burime të pasura.

Marrim çështjen e parë: karakteristikat e pazakonta të situatës në Shqipëri. Mund të jepen shumë shembuj, por unë mbaj mend tronditjen tonë kur arritëm në Tiranë. Nuk shikonim asnjë makinë nëpër rrugë. Në fillim menduam se ishte pushim por më vonë kuptuam që regjimi i mëparshëm nuk e lejonte pronësinë e makinave. Disa muaj më vonë, gjatë vizitës tonë të tretë, makinat kishin mbushur rrugët. Nuk kishte rregulla parkimi dhe shumë pak rregulla për ngarjen e makinës. Makinat nuk ishin të regjistruara dhe nuk kishte nevojë për patentë. Ishte e vështirë të kaloje rrugët – dhe mund ta imagjinoj që ishte pothuajse e pamundur të ngjisje makinën – dhe në fakt ishte një gjendje shumë konfuze. Kur pyetëm për këtë çështje, na thanë që makinat nuk lejoheshin më parë ndërsa tani lejoheshin. Pikë. Nuk ishte e nevojshme të ndërhynim më mbi të drejtat e pronësisë së automjeteve. Kufizimet duheshin mënjanuar.

Sigurisht kjo dukej se ishte normale pas shumë vitesh të kufizuar. Por, paqëndrueshmëria e kësaj situatë gjithashtu, pasqyrore një mësim interesant. Në një kohë kur liria është e kundërta e shtypjes, çrregullimi total dhe kaosi nuk është e kundërta e planifikimit qendror. Dhe sigurisht anarkia nuk është e kundërta e komunizmit. Kishte pika ndërmjetëse. Shërbimet publike, shërbimi publik, të dyja kërkojnë rregulla, direktiva, një strukturë ligjore dhe zbatim të saj. Shembull shumë i qartë për këtë është eksperiencia e hershme e Shqipërisë dhe gjithashtu, momentet e saj të hidhura në vitin 1997.

Dy pikat e tjera, cilësia njerëzore dhe aftësitë e shumta, sigurisht të kombinuara së bashku, e bëjnë Shqipërinë një vend që ka mundësi për sukses dhe rrjedhimisht, të begatë. Ne e cilësuam këtë potencial në një monografi të FMN-së, të publikuar në vitin 1992 duke përmbledhur të dhënat. E titulluam: “Shqipëria: Nga izolimi në reformë”. Sot, sigurisht, izolimi ka përfunduar, por reformat dhe zhvillimet institucionale vazhdojnë akoma dhe e ardhmja e ndritur për Shqipërinë do të realizohet, në qoftë se këto reforma dhe forcimi i institucioneve të saj, arrijnë të modernizojnë plotësisht ekonominë dhe ta integrojnë atë me pjesën tjetër të botës.

Do të dëshiroja të theksoja, me pozitën time në Bankën e Anglisë, që ne jemi të gatshëm të ofrojmë gjithë mbështetjen në fushën e bankëut qendror dhe jemi shumë të gëzuar të punojmë për vendosjen e një programi bashkëpunimi.

Në mbyllje, dëshiroj t’i uroj gjithë suksesin autoriteteve shqiptare dhe të falenderoj përsëri Guvernatorin për ftesën dhe që më dha mundësinë të kthehem sërish për të parë gjithë zhvillimin që Shqipëria ka patur gjatë këtyre viteve.

\* Mario I. Blejer: Banka e Anglisë.